Partia Demokratike e Kosovës dhe Partia e Drejtësisë kanë zhvilluar takime me qëllim të arritjes së një marrëveshje për koalicion parazgjedhor. Temë e diskutimit ka qenë edhe kërkesa për heqjen e udhëzimit administrativ që ndalon bartjen e shamisë nëpër shkolla.

Ish-deputeti i PD-së, në legjislaturën e fundit, Gëzim Kelmendi ka konfirmuar për lajmi.net se bisedimet me PDK-në janë zhvilluar gjatë ditëve të fundit.

I pyetur se a i ka vënë kusht partia e tij PDK-së heqjen e udhëzimit administrativ për bartjen e shamisë nëpër shkolla, Kelemendi e ka konfirmuar një gjë të tillë.

Ndonëse ka pranuar se koalicioni ende nuk është zyrtarizuar, ai ka thënë se PDK është pajtuar me kërkesën e tyre për shaminë.

“Ende nuk është nënshkruar asgjë, por ka pasur takime gjatë javës dhe ditëve të kaluara, por ende ky koalicion nuk është zyrtarizuar”.

“Po, heqja e shamisë ka qenë kërkesë e jona dhe PDK-ja është pajtuar me këtë kërkesë tonën”.

Nënkryetari i PDK-së, Adem Grabovci nuk ka qenë shumë i informuar lidhur me takimet me PD-në, prandaj ai nuk ka pasur një përgjigje nëse partia e tij është pajtuar për çështjen e shamisë. Gjithsesi ai beson se PDK do të lidhë koalicion me PD-në.

“Unë nuk kam qenë pjesë e takimeve me PD-në, por besoj që ka koalicion”.

“Pasi që nuk kam qenë pjesë e takimeve, nuk di asgjë lidhur me këtë gjë (çështjen e kushtit të PD-së)”, tha Grabovci për lajmi.net.

PD e Ferid Aganit ka qenë pjesë e Koalicionit për Kosovën e Re në legjislaturën e kaluar, dhe ka qenë pjesë përbërëse e qeverisë së Hashim Thaçi.

Partia Demokratike e Kosovës dhe Partia e Drejtësisë kanë zhvilluar takime me qëllim të arritjes së një marrëveshje për koalicion parazgjedhor. Temë e diskutimit ka qenë edhe kërkesa për heqjen e udhëzimit administrativ që ndalon bartjen e shamisë nëpër shkolla.

Ish-deputeti i PD-së, në legjislaturën e fundit, Gëzim Kelmendi ka konfirmuar për **lajmi.net** se bisedimet me PDK-në janë zhvilluar gjatë ditëve të fundit.

I pyetur se a i ka vënë kusht partia e tij PDK-së heqjen e udhëzimit administrativ për bartjen e shamisë nëpër shkolla, Kelemendi e ka konfirmuar një gjë të tillë.

Ndonëse ka pranuar se koalicioni ende nuk është zyrtarizuar, ai ka thënë se PDK është pajtuar me kërkesën e tyre për shaminë.

“Ende nuk është nënshkruar asgjë, por ka pasur takime gjatë javës dhe ditëve të kaluara, por ende ky koalicion nuk është zyrtarizuar”.

“Po, heqja e shamisë ka qenë kërkesë e jona dhe PDK-ja është pajtuar me këtë kërkesë tonën”.

Nënkryetari i PDK-së, Adem Grabovci nuk ka qenë shumë i informuar lidhur me takimet me PD-në, prandaj ai nuk ka pasur një përgjigje nëse partia e tij është pajtuar për çështjen e shamisë. Gjithsesi ai beson se PDK do të lidhë koalicion me PD-në.

“Unë nuk kam qenë pjesë e takimeve me PD-në, por besoj që ka koalicion”.

“Pasi që nuk kam qenë pjesë e takimeve, nuk di asgjë lidhur me këtë gjë (çështjen e kushtit të PD-së)”, tha Grabovci për **lajmi.net**.

PD e Ferid Aganit ka qenë pjesë e Koalicionit për Kosovën e Re në legjislaturën e kaluar, dhe ka qenë pjesë përbërëse e qeverisë së Hashim Thaçi.

- See more at: http://lajmi.net/pdk----dorezohet----para-pd-se_100066962.html#sthash.ny20juN5.dpuf

Partia Demokratike e Kosovës dhe Partia e Drejtësisë kanë zhvilluar takime me qëllim të arritjes së një marrëveshje për koalicion parazgjedhor. Temë e diskutimit ka qenë edhe kërkesa për heqjen e udhëzimit administrativ që ndalon bartjen e shamisë nëpër shkolla.

Ish-deputeti i PD-së, në legjislaturën e fundit, Gëzim Kelmendi ka konfirmuar për **lajmi.net** se bisedimet me PDK-në janë zhvilluar gjatë ditëve të fundit.

I pyetur se a i ka vënë kusht partia e tij PDK-së heqjen e udhëzimit administrativ për bartjen e shamisë nëpër shkolla, Kelemendi e ka konfirmuar një gjë të tillë.

Ndonëse ka pranuar se koalicioni ende nuk është zyrtarizuar, ai ka thënë se PDK është pajtuar me kërkesën e tyre për shaminë.

“Ende nuk është nënshkruar asgjë, por ka pasur takime gjatë javës dhe ditëve të kaluara, por ende ky koalicion nuk është zyrtarizuar”.

“Po, heqja e shamisë ka qenë kërkesë e jona dhe PDK-ja është pajtuar me këtë kërkesë tonën”.

Nënkryetari i PDK-së, Adem Grabovci nuk ka qenë shumë i informuar lidhur me takimet me PD-në, prandaj ai nuk ka pasur një përgjigje nëse partia e tij është pajtuar për çështjen e shamisë. Gjithsesi ai beson se PDK do të lidhë koalicion me PD-në.

“Unë nuk kam qenë pjesë e takimeve me PD-në, por besoj që ka koalicion”.

“Pasi që nuk kam qenë pjesë e takimeve, nuk di asgjë lidhur me këtë gjë (çështjen e kushtit të PD-së)”, tha Grabovci për **lajmi.net**.

PD e Ferid Aganit ka qenë pjesë e Koalicionit për Kosovën e Re në legjislaturën e kaluar, dhe ka qenë pjesë përbërëse e qeverisë së Hashim Thaçi.

- See more at: http://lajmi.net/pdk----dorezohet----para-pd-se_100066962.html#sthash.ny20juN5.dpuf